



Pese djemte e aksidentuar para pak ditesh ne Shkoder, kane trishtuar te gjithe shqiptaret. Nje prej tyre ka qene pjese e tifozeve te Vllaznise dhe per te respektuar kujtimin e tyre, tifozet e Partizanit kane menduar ti bejne homazhe te vecanta. Ultras Guerrils kane menduar te mos perdorin asnje mjet tifozerik ne ndeshjen qe do te luajne te shtunen me Vllaznine. Tifozet e Partizanit gjithashtu kane njoftuar se do te futen ne stadium me 15 minuta vonese ne shenje proteste ndaj dhunes qe policia ka perdorur ndaj tyre.